

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

Përshëndetje, të nderuar kolegë.

Dua t'ju uroj punime të mbara në këtë sesion të ri parlamentar!

Të dashur qytetarë,

Nuk mund të mos them disa fjalë për një çështje, e cila mendoj se afekton xhepat e qytetarëve, pra disa ndryshime dhe shtesa në buxhetin e vitit 2022, ku do të alokohet një shtesë prej afro 13 miliardë lekësh, nga të cilat 6,1 miliardë lekë do të shkojnë për një paketë ndihme, e ngjashme me atë të rezistencës sociale, ndërkohë që zërat e tjerë të kësaj shume prej 13 miliardësh, konkretisht 1,67 miliardë, do të shkojnë për kompensimin financiar të çmimeve të materialeve të ndërtimit, për punimet publike, për qiratë e banesave të të prekurve nga tërmeti, të cilët vazhdojnë në vitin e tretë të mbeten pa një banesë e tyre, për librat e shkollave e kështu me radhë.

Dua të fokusohem te ndihma ose paketa e rezistencës sociale prej 6,1 miliardë lekësh, e cila duhet të prekte dhe të shkonte për qytetarët shqiptarë në kushtet e krizës së çmimeve që jemi duke jetuar. Në fakt, me të drejtë njëra prej ministreve të kabinetit qeveritar tha se sot Kryeministri ju ka kapur të papërgatitur, sepse deputet e opozitës ishin përgatitur të kërkonin llogari në emër të qytetarëve: pse Shqipëria nuk e ka një paketë të rezistencës sociale, ndërkohë që edhe Kosova, shteti më i ri, pak ditë më parë shpalosi një të tillë për qytetarë e saj dhe në vlera më të konsiderueshme, më shumë se sa dyfishi i asaj që parashikon sot qeveria shqiptare?!

Është e vërtetë sepse Kryeministri e paska bërë me qëllim sot në mëngjes deklarimin se si do të ndahet në zëra kjo ndihmë për qytetarët, por unë me shumë interes dëgjova para 2 ditësh ministren e Ekonomisë dhe Financave, zonjën Ibrahimaj, në Komisionin Ekonomisë, e cila nuk kishte asnjë plan konkret se si do të shkonin të shpërndara këto para në xhepat e qytetarëve

dhe si do ta lehtësonin krizën e çmimeve, me të cilat përballen qytetarët shqiptarë çdo ditë. Megjithatë, sot në mëngjes, pa dyshim, edhe nga mediat e ndoqa me interes komunikimin e Kryeministrit, duke bërë edhe vetë si qytetare një llogari sa do t'i afektojë dhe sa do të lehtësojë kjo ndihmë, këto thërrime që qeveria shqiptare, e zënë në sedër nga të gjitha vendet e tjera të rajonit, ka planifikuar për t'ua dhënë qytetarëve shqiptarë.

Pra, sot që flasim, a kemi një plan se sa janë nevojat e shqiptarëve, e shtresave më në nevojë, e punëtorëve, të një familje të thjeshtë shqiptare me të ardhura minimale; sa janë nevojat e studentit, i cili duhet të përballojë kostot e rritura, rritjen e shumëfishtë të çmimeve të produkteve të shportës; sa janë nevojat e pensionistit, të cilit vazhdohet për shumë vite radhazi t'i indeksimit vetëm pensioni dhe kjo t'i propagandohet si rritje pensionit? Disa ditë më parë, siç e përmenda, Kosova dha një shumë të konsiderueshme rreth 150 milionë euro për qytetarët e saj, ndryshe nga paketa parë e Kryeministrit e qeverisë, kur përfitues ishin vetëm pensionistët dhe këta me selektivitet, në Kosovë ishin të gjithë, ishin punonjësit e institucioneve publike 100 euro shtesë, ishin pensionistët 100 euro shtesë, ishin studentët 100 euro shtesë, u nxit biznesi për të rritur pagat; u subvencionua shtesa e pagave, në rast se kjo do të ndodhte nga ana e bizneseve private, me qëllim që të kishte një shtrirje sa më të gjerë të ndikimeve dhe efekteve të kësaj pakete sociale.

U nxit kursimi i energjisë elektrike, duke subvencionuar dyfishin e asaj që kursehej nga qytetarët dhe familjet, krahasuar me një vit më parë, ndërkohë që krejt të kundërtën bëjmë ne. Çfarë bën qeveria shqiptare? E tha sot në mëngjes me krenari të madhe. Ndërkohë që ata e dyfishojnë ndihmën ekonomike, qeveria shqiptare e rrit me 10%, që, në fakt, është tallje me qytetarët shqiptarë, sidomos me këtë shtresë kaq në nevojë e kaq vulnerabël. Ndërkohë që rrisni me krenari dhe bëni vetëm indeksimin e pensioneve me 6%, i jepni fiks një thërrime atij pensionistit, pra asgjë konkrete përfundimtare e cila do të afektojë realisht lehtësimin e krizës, me të cilën përballemi. Në qoftë se do të bënim një krahasim, mendoj se sot është momenti për të parë dhe për të analizuar pak edhe paketën e parë të rezistencës sociale, që ju e shpallët në mars 2022.

Sot jemi disa muaj më pas, madje disa muaj edhe pas përfundimit të efekteve të kësaj pakete të rezistencës, ku u dhatë 100 lekë në ditë pensionistëve, ose 3 mijë lekë të rinj në muaj, pra 1 mijë lekë të vjetër në ditë. Çfarë mund të bëjë një pensionist me një kafe në ditë shtesë nga qeveria, në kushtet kur (ja ku e kemi tabelën aty) disa produkte të shportës janë rritur më shumë se 100% të vlerës së tyre, krahasuar me një vit më parë? Duhet theksuar se sot paga, pra një punëtor me një pagë minimale, një punonjës administrate apo e çfarëdolloj sektori, qoftë edhe ai privat, nuk ka pësuar asnjë lloj rritje dhe asnjë lloj indeksimi. Ju sot thoni se do të bëni indeksimin vetëm për Policinë e Shtetit, që është një kategori e paprekur nga rritja e pagës prej disa vjetësh. Shumë mirë, por e pamjaftueshme për të sjellë diçka konkrete që do të ndihet në ekonominë e familjeve shqiptare.

Ashtu siç e thanë edhe kolegët, sepse pa asnjë lloj dyshimi do të biem edhe në përsëritje, kemi një 8-mujor të këtij viti, i cili ka shënuar rekord në të ardhurat dhe në paratë e vjela në dogana, mbi 500 milionë dollarë shtesë, krahasuar me një vit më parë. Pa dyshim që këto para qeveria duhej t'i shpërndante, së paku një pjesë të mirë të tyre, te qytetarët për t'i lehtësuar, gjë që ju refuzoni ta bëni. Jemi në një kohë kur çmimi i karburantit në bursa ka rritur në nivelin para luftës, ndërkohë në Shqipëri vazhdon përsëri të funksionojë bordi antikushtetues i oligarkëve të naftës, të cilët së bashku me përfaqësues të institucioneve i përballin sot shqiptarët me çmimet më të larta të naftës dhe me taksat më të larta në rajon. Një tjetër pikë, ku dua të ndalem, janë edhe pensionistët. Kriteret selektive bëjnë që jo të gjithë pensionistët ta kenë përfituar 3-mijëlekëshin në muaj, sepse ka pasur shumë raste, mund t'juja them konkretisht, që e ka përfituar bashkëshorti, por jo bashkëshortja, pra nuk është zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë pensionistët.

Për sa u përket fermerëve, megjithëse me ata propagandohet, janë kategori e harruar, edhe pse kanë një peshë shumë të rëndësishme në numrin e përgjithshëm të vendeve të punës. U alokuan 5 milionë dollarë me paketën e marsit të vitit 2022 vetëm për naftën falas në bujqësi, shifër kjo që iu shtua 9-milionëshit të Ministrisë së Bujqësisë, duke shkuar në 14 milionë dollarë. Ku janë sot këto para, ndërkohë që vetëm 50% e fermerëve e kanë përfituar naftën falas dhe kur ka kaluar sezoni më i thatë i vitit, sezoni që ka nevojën më të madhe për naftë nga

ana e fermerëve? Pra, 50%-shi tjetër i fermerëve nuk ka përfituar asnjë litër naftë, përkundrazi, e ka blerë atë disafish më shtrenjtë sesa e kanë blerë jahtet luksoze. Ku është dora e shtetit? Ku janë subvencionet? Veçse propagandë e qeverisë ose paaftësi e saj për të menaxhuar këto para.

Shkaku përse procesi i shpërndarjes së naftës është ngadalësuar ndjeshëm, madje është stopuar, sipas informacioneve, është mungesa e buxhetit. Për çfarë i duhet një fermeri nafta në dhjetor, kur reshjet janë maksimale dhe ndërkohë po vjen sezoni i vitit 2023 për të aplikuar sërish për të? Së fundi, do të doja të sillja në vëmendje se, ndërkohë që vazhdon propaganda e naftës, keni hedhur edhe propagandën tjetër, atë të subvencionit të grurit. Zero interes, e kundërta e asaj që paraqisni ju. Për fermerët ky subvencion 30 mijë lekë për hektar është totalisht i pamjaftueshëm dhe nuk ka nxitur asnjëlloj interesi ndër fermerë, sepse vetëm plehurat kimike janë sot trefish më të shtrenjta, krahasuar me një vit më parë ndërkohë që vazhdon të lulëzojë monopoli i plehrave kimike.

Nuk ka asnjë lloj veprimi nga ana e qeverisë, përveç vendosjes së TVSH-së dhe vjeljes akoma më shumë edhe të fermerëve, të cilët janë të bindur tashmë se janë të vetëm përballë kësaj qeverie. Faleminderit!